



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.3.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Seancë dëgjimore me kryetarin e Entit Rregullator të Ujit, lidhur me raportin e veprimtarisë vjetore të këtij institucioni për vitin 2018 (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Besnik Baraj, Rrahman Rraja, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Gjetan Gjetani, Arben Pëllumbi, Dritan Bici dhe Edmond Leka.

Mungojnë:

Ilir Beqaj, Eglandina Gjermani dhe Lefter Koka.

Të ftuar:

Ndriçim Shani – kryetar i ERRU-së

Lindita Molla – anëtar, ERRU

Silvana Simaku – anëtar, ERRU

Fatime Imeraj – anëtar, ERRU

Rudolf Papa – anëtar, ERRU

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin. Në rendin e ditës së sotme kemi një seancë dëgjimore me kryetarin e bordit të Entit Rregullator të Ujit në lidhje me raportin e veprimtarisë vjetore të këtij institucioni për vitin 2018. Relator për këtë çështje është zoti Arben Pëllumbi.

Në këtë dëgjesë kemi ftuar të marrin pjesë përfaqësuesit e ERRU-së: Ndriçim Shani, kryetar i ERRU-së dhe anëtarët e ERRU-së Silvana Simaku, Lindita Molla, Fatime Imeraj dhe Rudolf Papa.

Fjala është për përfaqësuesit e ERRU-së për të prezantuar raportin dhe më pas do të vazhdojmë me pyetje dhe diskutime nga anëtarët e komisionit.

Ndriçim Shani – Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Ashtu si zakonisht pas çdo viti, ERRU raporton në këtë komision dhe më tej, edhe në parlament, në lidhje me veprimtarinë e vitit paraardhës. Pavarësisht se ju i dini mirë detyrat dhe ato me të cilat ne na ngarkon ligji, si përkufizim institucioni ynë është thjesht një formë moderne e ndërhyrjes së qeverisjes qendrore për të menaxhuar shërbimin e furnizimit me ujë në një ambient monopol. Shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimet janë shërbime monopol, prandaj domosdoshmërisht kanë nevojën e një enti të pavarur rregullator, siç është ERRU-ja për të rregulluar politikën tarifore për eliminimin e abuzimeve me këto shërbime monopol ndaj konsumatorëve.

ERRU ka si mision të garantojë që shoqëritë t'u ofrojnë të gjithë konsumatorëve në vend shërbimet më të mira të mundshme në lidhje me shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimet me një çmim të arsyeshëm, por nga ana tjetër ERRU ka edhe detyrën delikate të ekuilibrit të rritjes së qëndrueshmërisë financiare të operatorëve (ndërmarrjeve të ujësjellës kanalizimeve).

Detyrimet kryesore ligjore të ERRU-së janë:

- Vendosja e tarifave të shërbimeve UK për shoqëritë UK;
- Licencimi i shoqërive UK;

- Mbrojtja e interesave të konsumatorëve për garantimin e shërbimeve cilësore nga shoqëritë e ujësjellës - kanalizimeve, si ruajtja e tyre ndaj abuzimeve për shërbime me cilësi të dobët dhe me çmime abuzive.

ERRU vepron sipas parimit të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve, por njëkohësisht, lufton edhe për konsultimin financiar të shoqërive.

Raportimi i sotëm për veprimtarinë vjetore të ERRU-së është një detyrim ligjor, që rrjedh nga ligji nr. 8102, datë 28.03.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura“, i cili ka si qëllim kryesor pikërisht informimin dhe transparencën ndaj Kuvendit dhe ndaj aktorëve të tjerë për aktivitetin e institucionit tonë. Gjatë këtij raportimi bëhen të ditura edhe objektivat që ka ERRU për vitin në vazhdim dhe më tej, si dhe analizohet gjendja e performancës së sektorit të ujit për vitin që kaloi.

Duke pasur parasysh aktivitetet kryesore të ERRU-së: vendosja e tarifave të shërbimeve UK për shoqëritë UK; licencimi i shoqërive UK dhe aktivitetet e tjera, që do t'i detajojmë gjatë raportimit, theksojmë faktin se për t'u licencuar shoqëritë UK duhet të garantojnë kapacitetin profesional dhe integritetin moralo-ligjor për dhënien e këtyre shërbimeve për konsumatorët. Ata duhet të përmbushin dhe të garantojnë kushtet higjeno-sanitare për të gjitha komponentët e sistemeve, të cilat ato i menaxhojnë për ofrimin e këtyre shërbimeve.

Gjatë vitit 2018 kanë aplikuar për licencë apo rinovim të saj në total 35 shoqëri UK, nga të cilat ERRU ka licencuar 24 shoqëri, ndërsa 11 aplikime të tjera janë akoma në proces.

Arsyet e licencimit të kompanive në këtë numër të madh është imponuar kryesisht mbas reformës në sektor, nga ndarja e re administrative është futur në zonën e shërbimit pjesa më madhe e të gjitha zonave rurale që nuk ishin më parë, por edhe nga kërkesat e tjera që përcakton sfida e reformës në sektorin e ujit.

Duhet theksuar fakti që ka vështirësi, sepse pjesa e reformës administrative dhe futja në zonën e shërbimit të këtyre zonave të reja kryesisht rurale, ka pasur probleme në lidhje me vlerësimin e aseteve, që janë kërkesat ligjore për t'u licencuar dhe për t'u regjistruar më tej në QKB. Sidomos, një pengesë shumë e madhe është marrja e akt miratimit higjeno – sanitar, për të cilin do të flasim edhe më tej për vështirësitë që ka dhe përpjesën e detyrave jo thjesht të ERRU-së, por kryesisht të institucioneve të tjera që e kanë detyrë, sidomos për shoqëritë e vogla dhe ato që janë kryesisht në zonat e largëta, të cilat hasin vështirësi të mëdha për të gjetur personel me kualifikim të caktuar në përputhje me kërkesat ligjore.

Gjithsesi, gjendja është e tillë që ende në fillim të këtij viti 10 shoqëri janë në proces shqyrtimi për t'u licencuar dhe këtu fusim UK-të e Tiranës, të Fierit, Elbasanit, Bulqizës, Pustecit, Këlcyrës, Mallakastrës, Fushë-Arrëzit, Përmetit, Selenicës.

Janë 3 shoqëri të tjera, të cilave u ka mbaruar vlefshmëria e licencës: kanë aplikuar te ERRU-ja, sepse kanë vështirësitë që përmendëm si ndarja e aksioneve, marrja e akt miratimit higjeno – sanitar dhe këtu përmendim shoqëritë UK të Pukës, të Divjakës dhe të Peqinit, por ky i fundit i kaloi këto pengesa dhe jemi në procesin e dhënies shumë shpejt të licencës.

Janë 2 shoqëri të tjera, të cilat nuk kanë qenë asnjëherë të pajisura me licencë (në Klos), që është një shoqëri UK mjaft e vogël dhe ka shumë vështirësi për të përmbushur kërkesat ligjore për këtë punë, si dhe ujësjellësi i Kamzës, që në fakt nuk është shoqëri aksionere, por është një shoqëri që e ushtron veprimtarinë e saj si departament i Bashkisë së Kamzës.

Për përballimin e këtyre vështirësive ERRU kërkon të forcohet angazhimi i bashkive për përmbushjen e këtyre kërkesave ligjore, sepse në fund të fundit, ato janë pronare të ngarkuara nga ligji organik dhe janë përgjegjëse për ofrimin dhe menaxhimin e këtyre shërbimeve në zonat përkatëse administrative.

Gjithsesi, pavarësisht avancimeve që janë bërë në lidhje me plotësimin praktik të legjislacionit për akt miratimin higjeno – sanitar, patjetër ka hapa përpara dhe po shohim që është e monitoruar edhe nga ministria, por për hapat konkrete, sidomos në konceptin që duhet se çfarë përbën ky akt miratimi higjeno – sanitar dhe moskonfondimin e tij me inspektimin higjeno – sanitar, mbetet akoma shumë për të bërë. Propozohet:

1. Forcimi i angazhimit të bashkive për vlerësimin e aseteve;
2. Rishikimi i legjislacionit për akt-miratimin e lejes higjeno-sanitare

- Rishikimi i VKM-së nr. 63 për plotësimin e kërkesave për kualifikimet e stafit, të cilat i vënë në të njëjtin nivel pavarësisht nga dimensionin apo kualifikimi i shoqërisë së UK. Thënë në mënyrë më direkte, nuk mund të vëmë në të njëjtin pozicion kërkesash ligjore kualifikimin e stafit menaxhuese kyç të kompanisë si për Tiranën, që ofron shërbime për 1 milion banorë (dihen kapacitetet dhe mundësitë për t'i pasur ato), me një shoqëri UK të zonave të thella, pa ua përmendur emrat, se ju e keni shumë të qartë.

Në lidhje me miratimin e tarifave për Shërbimet UK, që është detyra tjetër kryesore dhe më e rëndësishmja, miratimi i tarifave për shërbimin e ujësjellës-kanalizimeve

Gjatë vitit 2018 ERRU ka miratuar tarifa për 8 shoqëri UK (Maliq, Gramsh, Skrapar, Vau i Dejës, Poliçan, Gjirokastrë, Malësi e Madhe, Librazhd-Përrenjas).

Janë në proces vlerësimi 11 aplikime të tjera në UK-të në Lushnjë, Vlorë, Roskovec, Delvinë, Krujë, Berat-Kuçovë, Bulqizë, Pustec, Vorë, Tropojë, Himarë.

Theksoj faktin që aplikimi për tarifa të reja për këto 11 shoqëri (pritet të vijnë edhe nga shoqëri të tjera), vjen nga kërkesa e domosdoshmërisë nga rritja e zonës së shërbimit dhe në mjaft raste, unifikimin e tyre, rishikimin e tarifave për të gjithë zonën, sepse ka pasur diferenca pjesa rurale me pjesën urbane.

Ndihet nevoja për rritjen e të ardhurave nga shoqëritë për të mbuluar, sidomos pjesën e kostove direkte të shërbimeve UK. Nga 58 shoqëri UK që kemi në vend, 42 prej tyre akoma nuk arrijnë të mbulojnë kostot direkte të operimit të mirëmbajtjes.

Kriteret që ne përdorim si institucion gjatë analizave tona për propozimet që na vijnë nga shoqëritë dhe nga bashkitë përkatëse. Natyrisht, ato aprovohen fillimisht prej tyre, vjen propozimi nga këshilli i administrimit. Është e rëndësishme t'i sqarojmë kriteret që përdorim gjatë analizës sonë të propozimit për tarifa, që në fakt kanë kostot për ofrimin e këtyre shërbimeve, ne bëjmë një analizë mjaft të hollësishme dhe të kujdesshme që merr në konsideratë vetëm kostot e arsyeshme dhe ato të justifikuara.

Kriter tjetër shumë i rëndësishëm është pjesa e përmirësimit të menaxhimit, që influencon në kosto dhe që përkthehet në objektivat që ne vendosim mbas miratimit të tarifave që kanë propozuar shoqëritë.

E fundit, është verifikimi i përballueshmërisë për të cilën jemi duke bërë mjaft kujdes në bazë të të dhënave që disponojmë nga INSTAT-i jo për të ardhurat, por për shpenzimet. Vlera e faturës së shërbimeve nuk duhet të kalojë vlerën prej 5% të shpenzimeve mesatare për familje me të ardhura të ulëta, jo për ato në nevojë. Familjet në nevojë janë me ndihmë sociale dhe kuptohet që ato kanë një politikë komplet tjetër dhe nuk merren parasysh si kriter tregues për të gjitha shtresat e tjera të popullsisë.

ERRU ka rishikuar metodologjinë e vendosjes së tarifave bazuar në një plan biznesi 5-vjeçar, që duhet të paraqesin shoqëritë UK një analizë kostoje të bazuar në të dhëna analitike, përfshirë dhe investimet, si edhe saktësimin e kriterëve për përballueshmërinë me përvoja të tjera ndërkombëtare, si dhe të dhënave të disponueshme nga INSTAT-i, duke pasur parasysh mbrojtjen e konsumatorëve me të ardhura të ulëta (jo mesatare).

Edhe aty ku UK-të nuk e kanë këtë plan biznesi 5- vjeçar mënyra e bashkëpunimit Me shoqëritë UK është e tillë që ato të bëjnë një analizë të ngjashme (mos të themi 100% të përputhshme) me atë që bëhet në lidhje me kërkesën për një plan biznesi 5- vjeçar dhe me kostot përkatëse të tyre.

Trajtimi i ankesave të konsumatorëve është një detyrë shumë e rëndësishme e ERRU-së, si institucion që mbron interesat e konsumatorëve nga shërbimi monopol i shoqërive UK. Ne i kushtojmë një vëmendje shumë të madhe kësaj detyre. Gjithnjë e më shumë pranë institucionit tonë vijnë ankesa në rritje, fakt që ne e shohim edhe në lidhje me besimin që po krijohet ndaj institucionit tonë, për seriozitetin që i trajton këto kërkesa në mbrojtje të interesave të konsumatorëve, pa u hyrë në hak shoqërive UK.

Gjatë vitit 2018 ERRU ka shqyrtuar dhe trajtuar 39 ankesa të ardhura kryesisht nga konsumatorët familjarë. Ne kemi një departament të veçantë mjaft të specializuar për këtë punë.

Natyra e ankesave është:

3. për faturimin aforfe;

4. për zëvendësimin e shpeshtë të ujëmatësit nga shoqëritë UK, pa respektuar procedurat, mosnjohja e detyrimeve nga ana e konsumatorëve, që pretendojnë se kanë qenë arbitrare nga ana e shoqërive të ujësjellësve ndaj tyre, si dhe probleme të ndryshme, që lidhen me kontratën e shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve ndërmjet Ndërmarrjes së Ujësjellësit dhe shoqërive.

Pjesa dërmuese e ankesave ka konsistuar në faturimin aforfe dhe në ndërrimin e shpeshtë të matësve, ku ne i kemi kushtuar një vëmendje tejte të madhe sqarimit të këtyre problemeve në të gjitha shoqëritë ku janë paraqitur këto ngarkesa nga konsumatorët. Deri tani, në fakt, sepse këto kanë edhe procedurat burokratike derisa shkohet në zgjidhjen përfundimtare të tyre. Nga këto 39 ankesa, dhjetë janë zgjidhur në favor të konsumatorëve, ndërsa pjesa tjetër është zgjidhur ose me mirëkuptim, pra pasi janë sqaruar mirë palët dhe nga ballafaqimet që ne ndjekim si procedurë në këto raste, ose janë ende në proces, sepse do, s'do, kanë pasur një natyrë të ndërlikuar, që kërkonte kohë për zgjidhjen e tyre.

Në lidhje me statusin e ankimeve gjyqësore, kemi pasur një ankim, ku kemi qenë edhe palë në gjyq, nga *Res Publica* dhe një konsumator, që e bënte të vlefshëm këtë lloj ankimi në gjykatë nga ana e tyre, por kemi pasur edhe katër kauza të tjera, të cilat lidheshin me detyrimet rregullatore, që nuk përmbushnin ndërmarrjet ndaj ERRU-së. Kauzat kanë qenë për Kukësin,

Rrogozhinën, Krujën dhe Peqinin. Gjithashtu kemi kryer inspektime nga të cilat, për shkeljet e gjetura, në tre prej tyre (për Kavajën, për Tropojën dhe për Dibrën), në përputhje me atë që parashikon ligji, janë vendosur gjoba deri në masën 300 mijë lekë kur kanë qenë pa licencë (rasti i Kavajës), në masën 100 mijë lekë nga mospagimi i pagesës rregullatore e kështu me radhë, pa hyrë në detaje.

Në lidhje me përpjekjet tona të vazhdueshme për përditësimin dhe përmirësimin e të gjitha instrumenteve rregullatore që ne kemi në dispozicion për kryerjen e aktivitetit tonë, vitin që kaloi vëmendja kryesore ka qenë te metodologjia e vendosjes së tarifave dhe te detyrat, detyrimet..., domethënë te pjesa më e rëndësishme dhe më e përgjegjshme e aktivitetit që ne ushtrojmë si institucion.

Metodologjia është e përfunduar dhe, kur them e përfunduar, pasi ka qenë edhe detyrë e rezolutës së Kuvendit për vitin e kaluar, është e përfunduar. Grupi i punës ka punuar për të gjitha ndryshimet dhe përmirësimet e nevojshme që kanë qenë në mënyrë, të themi, jo shumë të detajuar, por të përgjithshme. Ndryshimet dhe përmirësimet e nevojshme konsistojnë te metodika që të merrej parasysh se pjesa më e madhe e shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve janë të paqëndrueshme financiarisht dhe nuk mund të vendosen në të njëjtin nivel me ato që janë të qëndrueshme, që jo vetëm mbulojnë shpenzimet e operimit dhe të mirëmbajtjes, por një pjesë të mirë apo totalisht edhe ato të shpenzimeve totale.

Gjithashtu, një element tjetër, që në fakt e përmendëm më parë, është futur si prerogativë që detyrimisht kur propozohet për tarifa në metodologjinë që ne aplikojmë është edhe plani pesëvjeçar i biznesit, të cilin ato duhet ta paraqesin detyrimisht.

Niko Peleshi – Ju lutem, përfundojeni fjalën tuaj, sepse raportin e kemi të gjithë përpara, por t’u lëmë pak hapësirë edhe pyetjeve që mund të kenë kolegët deputetë.

Ndriçim Shani – Në rregull.

Instrument tjetër i rëndësishëm është përmirësimi i rregullores për seancën dëgjimore me publikun, si element shumë i rëndësishëm i bashkëpunimit dhe transparencës me publikun.

Në lidhje me aktivitetin financiar të ERRU-së, do të flas shkurtimisht. Planifikimi i të ardhurave ka qenë 48 milionë, nga të cilat kemi realizuar 80, duke mbledhur debitë e vjetra dhe rezultatet që kanë dalë edhe nga kauzat gjyqësore dhe që kanë shërbyer edhe si shembull. Nuk kemi probleme në lidhje me buxhetin për të ardhurat e aktivitetit tonë në vitin 2019.

Në lidhje me performancën e sektorit, keni një tabelë, ku jepen treguesit e performancës, por që jepen për periudhën nëntëmujore dhe ne i ekstra-punojmë ato. Në vija të përgjithshme kemi një përmirësim të lehtë të këtyre treguesve si rezultat, kuptohet, i angazhimit të stadeve menaxhuese të ndërmarrjeve, por kjo ka ardhur edhe si rezultat i reformës së sektorit të ujit, pavarësisht këtij përmirësimi jo të pritshëm, sepse në vlerë sasiore duhet të ishte shumë më i madh.

Niko Peleshi – Në rregull.

Fillojmë me pyetjet nga kolegët, ndërkohë shfrytëzoni përgjigjet për të dhënë edhe ato informacione që ndoshta doni t'i ndani me komisionin.

Kush nga kolegët e do fjalën për pyetje?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, fillimisht fjalën e ka relatori, pastaj anëtarët e tjerë të komisionit.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit për fjalën dhe për raportin që mbajtët!

Unë e kam parë me vëmendje raportimin tuaj dhe, në bashkëpunim me shërbimet e Kuvendit, mendojmë se për vitin 2018 ka një përmirësim të treguesve, kryesisht mbulimi i kostove, organizim-mirëmbajtje me 15%, gjithashtu rritjen e nivelit të matjeve e keni me 5%. Çmojmë se keni bashkëpunuar mirë në lidhje me mbledhjen e detyrimeve të prapambetura për pagesat vjetore rregullatore. Vlerësojmë memorandumin e mirëkuptimit që keni nënshkruar me Autoritetin e Konkurrencës për vitin 2018, gjithashtu edhe miratimin e rregullores së re për organizimin e seancës dëgjimore me publikun.

Nga ana tjetër, vëmë re se ka një përmirësim të lehtë të gjendjes financiare, e cila vjen kryesisht si rezultat i eliminimit të lidhjeve të paligjshme, rritjes së numrit të ujëmatësve të vendosur dhe arketimeve të debive të prapambetura. Por, gjithsesi, më duhet të theksoj se këto arritje nuk e përmbushin pritshmërinë e parashikuar nga reforma. Gjithashtu, na duhet të theksojmë se ndryshimet ligjore të nevojshme, me gjithë periudhën disavjeçare që diskutohen, nuk janë realizuar ende, si dhe besueshmëria e të dhënave në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve vazhdon të mbetet një situatë problematike.

Besoj se të gjitha këto do t'i paraqesim te rekomandimet që do të bëjmë për vitin 2019.

Gjithashtu, siç ju e theksuat, por edhe unë dua ta ritheksoj, me gjithë përpjekjet e bëra deri tani, nuk janë bërë ende ndryshimet e nevojshme në legjislacionin që rregullon dhënien e aktmiratimit higjieno-sanitar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kam një pyetje e cila lidhet me eficiencën e stafit. Ju e keni shpjeguar edhe në raport, edhe në analizën e bërë, por unë do të doja të dija: nga të gjitha ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve që kemi sot, cila është ndërmarrja që e ka më të lartë këtë tregues dhe ajo që e ka më të ulët?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – A mund t’ia sqaroni pak, se nuk e ka kuptuar?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Cilin tregues?

Arben Pëllumbi – Eficiencën e stafit.

Niko Peleshi – Në rregull.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I mbledhim të gjitha pyetjet dhe pastaj, ju lutem, përgjigjuni në grup.

Kush e do fjalën për pyetje?

Po, zoti Baraj.

Besnik Baraj – Faleminderit, zoti kryetar!

Në statusin tuaj ligjor një nga përgjegjësitë është edhe mbrojtja e konsumatorit. Meqenëse problematika ose sektori që ju mbulonit është vërtet shumë i rëndësishëm, unë kam dy pyetje.

E para lidhet me faktin që sot në tregun shqiptar gjithnjë e më shumë trokasit nëpër familje kompani të ndryshme, të cilat përpiqen të shesin pajisje që shërbejnë për filtrimin e ujit, pra për rritjen e cilësisë. A keni informacion të mjaftueshëm për t’u bërë publicitet të gjithë atyre ujësjellësve që, pavarësisht sa mund të mos përfshihen në të gjithë territorin shqiptar për shkak të cilësisë së kanalizimeve e të tjerë, mund t’u bëni publicitet atyre zonave, ku realisht konsumatori shqiptar mund të përdorë ujin e çezmës qoftë për gatim, qoftë edhe për ta pirë?

Ne jemi fatlumë, sepse Shqipëria i ka burimet ujore kryesisht malore dhe nuk kalojnë nëpër zona urbane. Me një fjalë, probabiliteti që uji të kontaminohet është i vogël, plus këtu trajtimi që i bëhet në ujësjellës e bën atë mjaft të përshtatshëm për t’u përdorur nga konsumatori

drejtpërdrejt, aq më tepër në këtë periudhë që çmimi, për të cilin sado ka relativisht ankesa kur ai e përdor edhe për t'u pirë e të tjerë, zbutet pastaj edhe vlera ose efekti financiar. Pra, pyetja e parë është: a është në fokusin tuaj, e thënë shkurt, publiciteti që duhet t'u bëni ujësjellësve të ndryshëm, që ofrojnë te konsumatori ujë të pijshëm dhe të përdorshëm drejtpërdrejt nga çezma, siç ndodh në rastin e Korçës ose të Pogradecit?

Pyetja e dytë. Në qoftë se unë, si qytetar, trokas te ju, meqenëse ju mbroni interesat e konsumatorit në nivel kombëtar: a mund të më rekomandoni cilat plazhe në Shqipëri janë më të përshtatshme për t'u përdorur nga turisti, nga qytetari e të tjerë? A e keni ju këtë informacion dhe tagrin që ta informoni atë lidhur me kualitetin e ujërave bregdetare, pra se cili është më i përshtatshëm?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Fjalën e ka zoti Suli dhe pastaj zoti Marto.

Rakip Suli – Faleminderit, zoti kryetar!

Normalisht pa ujë nuk ka jetë, sikurse pa energji, nuk ka ekonomi, unë kam dy pyetje.

Së pari, meqenëse ju thatë që për vitin e kaluar, në mos gaboj, nga 26 ndërmarrje janë licencuar një pjesë, ndërsa një pjesë tjetër jo...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dua të di arsyen pse nuk janë licencuar dhe çfarë kriteresh nuk kanë plotësuar.

E dyta, disa herë gjatë diskutimit thuhej: “monopol, monopol”. A mendoni se sot nuk duhet të jetë koncepti “monopol” dhe çfarë rruge keni gjetur ju, në mënyrë që pjesa e shitjes të mos jetë monopol, flas e çdo bashkie në Shqipëri? Sepse kur thua: “monopol”, do të thotë se ajo e ka në dorë për ta shitur sa të dojë vetë, të veprojë si të dojë vetë...

Tani mendoj: ose ndoshta ju u shprehët gabim, duke e përmendur disa herë fjalën “monopol”, ose duhet një rrugëzgjidhje për të dalë nga kjo pjesë.

Këto dy pyetje kisha.

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Suli!

Po, zoti Marto.

Andrea Marto – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë dua një sqarim lidhur me realizimin e objektivave të reformës që kemi ndërmarrë në sektorin e ujit, e cila synonte që çdo bashki të kishte shoqërinë e saj të ujësjellës-

kanalizimeve. Kjo gjë duhej të ishte realizuar kohë më parë, ndaj shtroj pyetjen: pse nuk është arritur objektivi?

E dyta, a ka ndonjë vlerësim kur do të arrihet objektivi?

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Fjalën e kanë kërkuar zoti Rrahja, zoti Leka dhe pastaj zoti Bici.

Rrahman Rrahja – Përshëndetje!

Ashtu sikurse e thanë edhe kolegët, se pa ujë nuk ka asgjë, unë dua t’ju drejtoj vetëm një pyetje: a i bëhen analiza ujit të pijshëm? Sepse unë vetë kam qenë dëshmitar dhe kam parë këto botet, që i shesin me licencë ose jo, duke i mbushur në lumë. Kuptohet, për shembull, lumi i Tërkuzës, ku është burimi më i madh i mikrobeve, ku hidheshin edhe krejt mbeturinat e Kamzës, poshtë tyre mbushnin botin, ujin e të cilin patjetër do ta pinin banorët e Kamzës, sepse ato bote tregtoheshin në Kamëz. A ka ndonjë rregull? A i kontrollon kush? A kanë, apo jo, licencë këto?

Pyetjen e dytë e kam për tarifat. Ju thatë që do të vendosen tarifa të reja. A ka kritere se mbi ç’bazë do të vendosen këto tarifa?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Po, zoti Leka.

Edmond Leka – Faleminderit, zoti kryetar!

Dua të bëj një pyetje lidhur me një problematikë të madhe që kanë sot bashkitë. Ne dimë se prodhimi i ujit del me kosto tejet të lartë dhe se shumë bashki kanë detyrime të mëdha ndaj OSHEE-së. Si është menduar të zgjidhet përfundimisht ky problem? Sepse, me sa di, konkretisht Bashkia e Vlorës ka një detyrim që e ka të pamundur ta shlyejë ndaj OSHEE-së (është detyrim i mbartur në vite), madje ka momente të caktuara ku OSHEE-ja ndërpret edhe energjinë elektrike në stacionet e pompave për prodhimin e ujit. Dua të di: si është menduar që ky problem të marrë një zgjidhje përfundimtare?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Po, zoti Bici.

Dritan Bici – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë kam pyetje lidhur me formën juridike të ndërmarrjeve të ujësjellësve, çështje për të cilën kemi folur edhe vitin e kaluar për këtë problem. Reforma në qeverisjen vendore them se duhet të shoqërohet edhe me një reformë në organizimin e ndërmarrjeve të ujësjellësve, të cilat

në shumicën e rasteve janë “sh.a” me dy nivele të organizimit: me asamble të aksionerëve dhe me këshill mbikëqyrës.

Kjo ka qenë në rastet kur bashkia dhe komunat bashkë kishin në administrim ujësjellësit, por në atë kohë ishte e domosdoshme asambleja e aksionerëve, pasi, në bazë të aksioneve që kishte, kjo asamble kishte përfaqësues nga çdo komunë dhe bashki, por edhe përfaqësuesit e tyre në këshillat mbikëqyrës, që në shumicën e rasteve (këta këshilla mbikëqyrës) janë abuzivë, sepse fillojnë me qokat e politikës, që te kryetari i bashkisë, i cili merr ca lekë aty si anëtar i këshillit mbikëqyrës, ose dikush-dikush tjetër... Them se ka ardhur momenti që kjo mënyrë organizimi... A mundet që shoqëritë aksionere të ujësjellësve të kenë një tjetër mënyrë organizimi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Siç e thashë, deri tani kanë qenë me dy nivele. Tani që aksionere e vetme është bashkia, a mundet që këto shoqëri të vazhdojnë me këto dy nivele administrimi, sepse edhe ligji “Për shoqëritë aksionere” është disi i vjetër, për të mos thënë, qëkur e ka bërë Argita Berisha? Ndoshta ka ardhur momenti që ta shohim këtë aspekt.

Pyetja e dytë ka të bëjë me funksionimin e drejtimit të ujërave të ndotura, që do t’u kalojë ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve. A ka filluar, a ka ecur nëpër këto ndërmarrje ky drejtim? A ka filluar puna që këto ndërmarrje të organizohen, pra të kenë drejtuesin teknik, dhe të krijojnë stafet nëpër ndërmarrjet e ujësjellësve, si dhe stafin që do të trajtojë ujërat e ndotura?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit!

Ka ndonjë pyetje tjetër nga kolegët? Në qoftë se jo, unë kam dy-tri pyetje të shkurtra.

Së pari, dua të them që ka ndodhur një ndryshim esencial pas reformës territoriale, për mendimin tim, edhe në raport me ujin, për shkak se tani kemi bashki më të mëdha dhe më të forta, kemi më shumë ekonomi shkalle, por edhe fill pas reformës, që ju e përmendët, reforma e ujit, në qoftë se mund ta quajmë kështu, u ka dhënë më shumë përgjegjësi kryetarëve të bashkive, natyrisht edhe më shumë kompetenca, më shumë autoritet.

Kështu, është rritur shumë mundësia për të përmirësuar shërbimin, bazuar te shkalla më e madhe tani, të paktën potencialisht e ndërmarrjeve të ujësjellësve, por edhe e kompetencës së shtuar të kryetarëve të bashkive.

Pyetja e parë që kam është: sa bashki deri tani e kanë realizuar qasjen e reformës “një bashki – një ujësjellës”? Sepse, siç e dimë, çdo bashki ka trashëguar disa ujësjellës: ujësjellësin e qytetit dhe pastaj për çdo fshat ose grup fshatrash nga një ujësjellës, ku këta të fshatrave, natyrisht, janë shumë më të paorganizuar dhe me më pak kapacitete sesa ato të qyteteve. Ndaj qasja e reformës, nuk besoj se jam i gabuar, është të shkojmë fillimisht drejt asaj “një bashki – një ujësjellës” dhe pastaj, siç edhe ju e rekomandoni për vitin korrent e në vazhdim, të shkojmë drejt agregimit, mundësisht edhe më të madh, pra të fillojmë të kemi ujësjellës që i shërbejnë edhe më shumë se një bashkie, pra edhe një rajoni të tërë dhe ndoshta në një të ardhme të largët perspektiva mund të jetë: “E gjithë Shqipëria – një ujësjellës” në rastin më ideal. Pyetja është: sa bashki kanë ecur me ritmin e duhur, pra sa bashki kanë arritur të kenë vetëm një ujësjellës për të gjithë bashkinë?

Së dyti, a ka një projeksion se si do të shkojë numri ose sasia e subvencionit që disa ujësjellës kanë ende nevojë të marrin nga shteti? Pa dyshim që synimi dhe vizioni është të shkojmë drejt zeros, pra ujësjellësit të mbahen vetë, por kemi ende ujësjellës të dobët financiarisht qoftë për shkak të borxheve, qoftë për shkak të teknologjisë apo edhe të kostos, që kanë nevojë për subvencion.

Folëm për agregimin, që ju e keni përmendur si një nga sfidat e së ardhmes. Në qoftë se keni ndonjë gjë më konkrete ose dijeni për strategjinë e agregimit, a mund të na thoni, edhe për publikun, cila do të jetë perspektiva për sa kohë që ne do të shkojmë drejt asaj sa është numri i ndërmarrjeve, i ujësjellësve? Si është plani, të shkojmë për dhjetë vjet, për shembull, në një ujësjellës për të gjithë Shqipërinë, apo të shkojmë për dhjetë vjet në katër ujësjellës për katër rajone? Në qoftë se ka një plan të tillë na e thoni, pasi besoj se është me interes edhe për publikun, por edhe për anëtarët e komisionit për ta ditur si rrugë.

E fundit, për sa u përket tarifave, padyshim që për cilësi më të mirë duhen më shumë shpenzime dhe për më shumë shpenzime duhen më shumë të ardhura nga konsumatorët. Të ardhurat rriten me mirëmenaxhim, por edhe me tarifa. Çështja e tarifave ka ndjeshmëri shumë të lartë për shkak se ndonjëherë, në mos rëndom, edhe spekulohet. Sa herë që një bashki kërkon rritje tarifash, menjëherë anëtarët e këshillit bashkiak të krahut tjetër politik spekulojnë dhe godasin iniciativën e kryetarit të bashkisë, që, në fakt, mund të jetë e domosdoshme për të garantuar cilësi në shërbimin e ujit për konsumatorët.

Keni bërë ju një vlerësim nëse ka ende hapësira, pa hyrë në detaje, për rishikim të tarifave, për dhënie të hapësirës bashkive për të rritur tarifat aty ku është e nevojshme, në mënyrë që të kenë më shumë të ardhura dhe mundësi për më shumë investime?

Ju kërkohet të jeni sa më konciz në përgjigje meqenëse janë edhe disa pyetje të tjera që kërkojnë përgjigje.

Ndriçim Shani – Faleminderit!

Për sa u përket konstatimeve dhe pyetjeve të relatorit për raportin tonë, pritshmëria nga reformat ka rezultuar e dobët: ndryshimet ligjore nuk janë realizuar, saktësia e të dhënave, si dhe problemi i rregullimit që duhet të ketë aktmiratimi higjeno-sanitar. Në fakt, ishte bërë një lloj vlerësimi paraprak që pritej rreth 20% e përmirësimit të ujit pa të ardhura nga lidhjet e paligjshme. Rezultoi që më e mira e mundshme të ishte 1,5%. Kjo ishte një nga surprizat jo të pritshme të reformës që nuk influencohet në pritshmëri. Kur themi lidhje të paligjshme e kemi fjalën për konsumatorë dhe të ardhura plus. Në këtë kuptim, në bisedat apo takimet që kemi pasur me aktorët kryesorë që merren me këto vendimmarrje, duke filluar që nga ministria, kemi konstatuar që duhet rishikuar fokusi në bazë të një analize që kryesisht lidhet me kontratat e performancës që janë lidhur ndërmjet bashkive dhe ministrisë nëpërmjet KUN-it. Kuptohet, këto kontrata kanë qenë të lidhura me indikatorët performanciar apriori që duheshin arritur. Koha e vogël në dispozicion që të kishim një vlerësim të saktë që të shërbente si bazë për kontratën e performancës për çdo shoqëri ishte mjaft e ulët. Në fund të fundit, kjo duhet të shërbente që me impenjimin, monitorimin dhe angazhimin e çdo ndërmarrjeje ujësjellësi për reformën të shikohej se ku ishte maksimumi i arritshëm i atyre objektivave që ishin vendosur dhe ato të shërbenin si bazë për vitin pasardhës. Kjo punë u ndërpre. Ne u kemi sugjeruar që duhet vazhduar me këtë lloj kontrate performancë, të bëhet vlerësimi i saktë i treguesve të tyre, të vendosen objektiva reale dhe të arritshme që janë të lidhura edhe me incentiva, që përkthehen me ...

Kur themi subvencione, ato subvencione jepen në bazë të këtyre vlerësimeve që bëhen. Në këtë drejtim, sugjerimi ynë ka qenë që duhet përfshirë patjetër ERRU-ja. ERRU-ja është institucioni që monitoron të gjitha ndërmarrjet. Nuk i bën ministria. Ky është një lloj handicapi që ndoshta duhet pasur parasysh në strategjinë në të ardhmen për zbatimin e një reforme të suksesshme. Përfitoj nga rasti të them që nuk mund të bëhet në një kohë kaq të shkurtër sa është në perceptimin e konsumatorëve. Reforma kërkon kohën e vetë. Gjendja në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve nuk përmirësohet dot brenda një dite dhe as brenda një viti. Ajo kërkon

kohën e vetë, sepse është një sektor mjaft i vështirë, më i vështirë se sektori energjetik, dhe kërkon një vëmendje të veçantë dhe impenjim akoma më të madh, aq më tepër që është një sektor i decentralizuar. Në qoftë se në sektorin energjetik ne do të merreshim vetëm me një aktor, sepse është i centralizuar, këtu, duam apo jo, do të merremi me 61 aktorë, kryetarët e bashkive.

Ndryshimet ligjore nuk janë realizuar. Ato ne i kemi propozuar, i kemi pasur gati, por, siç shkruhet edhe në raport, Ministria e Infrastrukturës nxori një urdhër për krijimin e një ligji të ri për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve. Kjo e ndërlikoi situatën në pjesën tonë, ku mendohej të futej edhe rishikimi i ligjit, për të cilin ne jemi fare të qartë. Propozimet tona i keni të detajuara në funksion të përmirësimit të performancës të të gjithë sektorit dhe vetëm jo të institucionit tonë, sepse ne nuk rregullojmë thjesht institucionin tonë.

Ky proces ka ndaluar. Kemi kontradiksionet tona me mënyrën si u servir kjo pjesë. Duhet të rishikohet Kodi i Ujit. Nuk është nevoja të bëhet me VKM, por është kompetencë e jona. Është një marrëdhënie ligjore kontraktuale ndërmjet operatorit dhe konsumatorit, e cila kërkon garant një institucion të specializuar siç është ERRU-ja. Gjithsesi, draftin tonë ne e kemi të miratuar, të plotë dhe të gatshëm në të gjitha pikat kyçe që ne mendojmë se janë të rëndësishme për t'u përmirësuar dhe presim që të tejkalohet kjo pengesë.

Në lidhje me saktësinë e të dhënave, gjithmonë e kemi theksuar, edhe në vitet e mëparshme, që njësia e monitorimit dhe ... ku është baza e të dhënave, është te ministria, ndërkohë që duhet të jetë te ne. Pavarësisht kësaj, sivjet ne kemi marrë iniciativën për të krijuar sistemin tonë të bazës së të dhënave. Kështu që, në raportin tonë nuk do të shkruhet më burimi i bazës së të dhënave nga njësia e monitorimit, KUN-i, por do të mbajmë ne përgjegjësi deri në fund.

Ne kemi mundësinë dhe autoritetin, si dhe pjesën logjistike që e mbulojmë mjaft mirë nga ana profesionale, që këtij elementi kaq kritik të saktësisë së të dhënave (një e dhënë e gabuar nxjerr konkluzione të gabuara), ne sivjet do t'i japim një rëndësi mjaft të veçantë. Kemi menduar të hartojmë një sistem shumë praktik dhe të thjeshtë në mënyrë që të kemi mundësi verifikimi dhe raportimi me një Excel, që neve na shërben për të gjithë bazën e treguesve të performancës për të monitoruar ndërmarrjet. Pra, presim që në këtë drejtim të përmirësohet mjaft cilësia e të dhënave.

Për sa i përket aktmiratimit higjeno-sanitar, është një pikë mjaft nevralgjike. Janë organizuar takime me Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor, me Ministrinë e Shëndetësisë dhe

Ministrinë e Infrastrukturës. Ndërkohë, nga ana ligjore ne e kemi thjesht: na jep këtë dokument dhe me ne je në rregull. Pjesa e të gjithë backgroundit se si duhet të arrihet aty janë përgjegjëse institucione të tjera. Ajo që ne kemi theksuar fort është koncepti i kësaj pune. Jo çdo element i sistemit të furnizimit me ujë... Nëse kemi 200 kontrolle në formatin e inspektimit higjeno-sanitar dhe nuk del njëra prej tyre, nuk lëshohet aktmiratimi higjeno-sanitar? Aktmiratimi higjeno-sanitar jepet në momentin që në rubinetin e konsumatorit uji del i pijshëm dhe i garantuar nga kualiteti bakteriologjik i tij. Me iniciativën nga Kryeministria ka filluar përcaktimi i pikave të monitorimit nga rrjeti shpërndarës. Deri tani në është bërë në katër qytete dhe duhet ndjekur me rigorozitet. Institucionet përkatëse përgjegjëse bëjnë detyrën e tyre (drejtoritë e shëndetit publik) për analizat ditore. Kur themi që bazë të këtyre analizave, që duhet të bëhen për çdo ndërmarrje furnizimi me ujë dhe kanalizime për 1 javë, 2 javë apo 1 muaj, dalin analizat e ujit të pijshëm, duhet dhënë aktmiratimi higjeno-sanitar. Inspektimi higjeno-sanitar është problem tjetër. Duhet profesionalizëm që të lihen detyrat e shtëpisë për të gjitha problemet që kanë të gjithë komponentët e ujësjellës-kanalizimeve, me qëllim që të zvogëlohet sa më shumë risku i kontaminimit që mund të ketë uji nga rrjeti shpërndarës. Kontaminime ndodhin edhe në Paris, edhe në Romë, por ata i kanë koeficientët e inspektimit higjeno-sanitar dhe detyrat e shtëpisë me afate dhe me para, sepse ka edhe detyra që i tejkalojnë mundësitë reale që kanë ndërmarrjet e ujësjellësve. Në këtë drejtim, duhet që e gjithë pjesa rregulluese e këtij elementi mjaft delikat që lidhet me shëndetin publik të shikohet në aspektin praktik. Pra, duhet të propozojmë zgjidhje praktike dhe të vëmë njerëzit në punë që të japin kontributin e tyre që sistemet të monitorohen dhe shkalla e riskut për kontaminimin e ujërave nga përzierja apo arsye të ndryshme të jetë sa më minimale.

Kjo është pjesa e aktmiratimit higjeno-sanitar, që në një farë mënyre nuk na takon, sepse nuk e kemi për detyrë. E kemi ndjerë me të vërtetë detyrë dhe e kemi shtyrë mjaft fortë. Është detyrë e institucioneve të tjera që ta vazhdojnë këtë punë.

Niko Peleshi – Ka pyetje të tjera?

Ndriçim Shani – Për sa i përket stafit, më i mirë është stafi i Korçës dhe më pas Tirana. Korça në mënyrë absolute, sepse ka një menaxhim super, jo se kryetari është nga Korça.

Niko Peleshi - Pyetja ishte sa larg është Korça nga bashkitë e tjera?

Ndriçim Shani - Është ndërmarrja e ujësjellësit më e mirë në Ballkan.

Niko Peleshi – Është e vërtetë dhe kjo sipas raportit të evaluimit nga Banka Botërore.

Ndriçim Shani – Në Tiranë, për efekt të ekonomisë së shkallës, bëhet fjalë për 300 000 lidhje. Nuk mund të themi që Peqini, Këlcyra dhe Hasi, që kanë nga rreth 20 mijë lidhje... Nëse ti ke për zonën tënde të shërbimit 50 sisteme të tjera fshatrash, që të gjitha kërkojnë menaxhim, rritet artificialisht ky raport. Pra, duhet parë rast pas rasti. Kjo është puna që ne po bëjmë. Kur propozohet për tarifa, të na japin edhe të dhëna të tjera. Cila është organograma, justifikimi i pozicioneve, e kështu me radhë. Që një depo 100 metër kub të jetë në rregull nga ana higjieno-sanitare duhet të ketë 4 vetë në turn dhe të jetë 24 orë. Ndërkohë, ka zgjidhje të tjera me kamera apo edhe me siguri që është e pamundur për të ndërhyrë. Janë njerëz që nuk bëjnë asnjë punë, nuk garantojnë asgjë nga ajo që mendohet se duhet të jenë, dhe rrisin artificialisht shpenzimet, që dalin tregues të tillë paradoksalë.

ERRU-ja duhet të bëjë publicitet për ndërmarrjet e ujësjellësve që ofrojnë ujë të pijshëm. Çdo ujësjellës duhet të ofrojë ujë të pijshëm. Është detyrë e drejtorive të shërbimit publik të ndërmarrjeve të ujësjellësit të bëjnë një propagandë të tillë, pasi të garantojë që cilësia e ujit në burim është e garantuar me të gjithë parametrat fizikë dhe kimikë, pjesa bakteriologjike nuk diskutohet dhe të merren masa nga rreziku i kontaminimit që bëhet gjatë rrugës me anë të dezinfektimit. Në Shqipëri gjithmonë uji ka qenë i pijshëm. Si bëhej i pijshëm? E lije 15 minuta rubinetin hapur, sepse rrjedhja garanton që është i pijshëm. Nëse kemi përzierje uji, atëherë bëhen analizat ditore, për të cilat folëm. Plazhet nuk janë në targetin tonë. Ato janë në varësi të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, që bën monitorimin e ujit në plazhe.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ajo është pjesë e një strategjie kombëtare të veçantë në lidhje me kualitetin e ujit dhe mbrojtjen e ambienteve.

Deri tani janë licencuar 32 bashki.

Niko Peleshi – Shumë mirë që janë licencuar, por a kanë arritur ndërkohë që t'i fusin të gjithë ujësjellësit e fshatrave nën një administrim?

Rakip Suli - Pa i futur të gjithë ujësjellësit e fshatrave nën një administrim ne nuk lëshojmë licenca, pra pa bërë riorganizimin e shoqërive sipas zonës së *e-shërbimit*, ku futet i gjithë territori administrativ që presupozon reforma territoriale.

Niko Peleshi – Më falni, ka një ndërhyrje nga zoti Suli.

Rakip Suli- Cilat janë kriteret që nuk kanë plotësuar këto bashki, ose këto ndërmarrje, ose këto subjekte, që nuk janë licencuar?

Nëse nuk i kanë plotësuar, cila ka qenë pengesa e tyre për të mos i plotësuar?

Ndriçim Shani - Atëherë tri janë kërkesat kryesore për licencim: të jenë të regjistruar të gjitha asetet në QKB, sipas zonës së shërbimit që mbulon të gjithë territorin administrativ, të jetë bërë vlerësimi i aseteve nga një ekspert kontabël i miratuar dhe me radhë plotësohet i gjithë dokumentacioni dhe pastaj QKB-ja lëshon atë që je i regjistruar sipas zonës së *e-shërbimit*, kualifikimi i stafit, që e përmenda më parë, dhe kërkesa e tretë është aktmiratimi i gjendjes sanitare.

Rakip Suli - Të mos futemi në detaje tani. Asetet nuk duan 10 vjet të bëhen, duhen bërë brenda një viti. Si e matni eksperiencën e stafit?

Sa për kriterin e parë, është turp ta dëgjojë njeri, nuk licencohet, sepse nuk ka bërë regjistrimin e aseteve. Nëse nuk bëhen këto tri kritere, a keni ndonjë fuqi ju për të marrë masa ndaj këtyre ndërmarrjeve? Është turp që të mos licencohet, se nuk ka bërë regjistrimin e aseteve.

Ndriçim Shani - Në lidhje me kualifikimin e stafit, drejtuesi teknik duhet të jetë inxhinier, hidroteknik ose inxhinier ndërtimi.

Rakip Suli – Nëse kërkohet inxhinier ashtu duhet të jetë, të mos i hyjmë kësaj pune.

Ndriçim Shani - Tani, nëse doni përgjigje na dëgjoni, kur them do inxhinier, do inxhinier, por Fushë-Arrëzi nuk e gjen dot inxhinierin, atëherë si të veprojmë?

Ilir Ndraxhi – Në Shijak ujësjellës kanalizime menaxhohet nga Bashkia e Durrësit. Nga stacioni i pompimit te Ura e Gjolës, që furnizohet Bashkia e Shijakut, ka qenë investim i para viteve '90, dhe ka qenë vetëm për qytetin e Shijakut. Pyetja është si do të veprohet në vijim, sepse aty do të furnizohet edhe Bashkia e Krujës, e Vorës dhe e qytetit të Shijakut?

Pra, si mund të kërkohen nga bashkitë pagesat e korrentit që harxhohet në mënyrë të përbashkët, humbjet që ka rrjeti dhe pagesat e familjarëve?

Ndriçim Shani - Ujësjellësi i Fushë-Krujës për të cilin ju flisni është pjesë e të gjithë zonës së shërbimit të Ndërmarrjes së Ujësjellës Kanalizimeve Durrës. Ju kërkoni që të ndahet ndërmarrja, të jetë entitet në vete, por, nëse duhet të ndaheni, duhen ndjekur të gjitha procedurat ligjore për këtë punë, për pjesën e aksioneve që keni dhe të ujit që merr Vora, sepse nuk është aksionere.

Ilir Ndraxhi – Nuk është problemi të ndahemi, por ne nuk kemi ujë. Ky është problemi.

Ndriçim Shani - Për të gjitha kostot që kemi del një çmim i prodhimit të ujit, por për këtë duhet bërë propozim. Për shitje uji me shumicë për Vorën, nëse doni ose Krujës, janë marrëdhënie të cilat duhet t'i rregulloni me agjencinë e basenit, të Ishmit dhe Shkumbinit që ju përmbledh. Pra, janë detaje të tilla, që kanë të bëjnë me konceptin. Nëse doni të ndaheni, kjo është rruga, të cilën absolutisht nuk jua rekomandojmë, sepse, ashtu siç u tha edhe këtu, ne pretendojmë agregimin. Detyra juaj vështirësohet ende më shumë.

Ilir Ndraxhi – Nuk është fjala për t'u ndarë.

Ndriçim Shani - Nëse doni të ndaheni, vështirësohet më shumë.

Ilir Ndraxhi- Ne nuk duam të ndahemi, ne duam ujë.

Ndriçim Shani – Ky është problem që duhet të ndiqen edhe lidhjet e paligjshme dhe shpërdorimet që ndodhin, si dhe pajisjen me ujëmatës të të gjithë konsumatorëve. Për këtë duhet të ngulmoni ju me autoritetin që keni, sepse keni aksione. Shijaku është aksioner dhe në mbledhje e aksionerëve të vihet para përgjegjësisë ujësjellësi që të japë një raport analize të veçantë lidhur me këtë problem.

Niko Pelshi – Lidhur me çështjen e tarifave, ju lutem, cili është mendimi juaj? Pra, a ka hapësira për rritjen e tarifave për bashki të caktuara?

Ndriçim Shani - Në lidhje me problemin e tarifave, ka pasur mendime në portale sikur ERRU-ja do të rritë tarifat. Rritja e tarifave nuk është qëllim në vetvete dhe ERRU-ja funksionon në bazë të propozimit që vjen nga bashkitë dhe ndërmarrjet në lidhje me tarifat. Ne bëjmë pjesën profesionale dhe rregullatore për atë që thamë në lidhje me kostot e justifikuar për problemet e përmirësimit, të menaxhimit, që duhet të kenë shoqëritë e ujësjellës-kanalizimit dhe, natyrisht, vijmë te pjesa e aftabilitetit ose e përballueshmërisë, për të cilën ne bëjmë gjithmonë verifikime. Ka raste që ka limite për shtresat me të ardhura të vogla, për shembull, për Durrësin dhe Korçën, meqenëse i referohemi treguesve që jep INSTAT-i. E theksoj faktin që ne nuk propozojmë rritje tarife, neve na propozohet rritje tarife, ne bëjmë analizën dhe gjejmë atë ekuilibër, qëndrueshmëri financiare të ndërmarrjes dhe interesave të konsumatorëve, ne gjejmë pjesën më të arsyeshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për punën e borxhit me OSHEE-në është bërë një mbledhje në Ministrinë e Infrastrukturës, në të cilën kanë marrë pjesë shoqëritë më problematike, madje prezente ka qenë edhe komisionerja që mund të flasë më në detaje.

Silvana Simaku- Ideja është që janë shumë ujësjellës që janë debitor nga OSHEE-së për shkak të faturës së lartë në vite. Ne si ent rregullator kemi propozuar që të mbahet një çmim më i ulët për ndërmarrjet e ujësjellësit për shkak se ato japin shërbim publik, përderisa ky shërbim publik është jetik, ata nuk kanë pse të paguajnë si një biznes privat dhe fitimprurës, ndërkohë që dihet se ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve nuk janë ndërmarrje fitimprurëse, përkundrazi, marrin subvencione nga shteti.

Për deri sa marrin subvencione nga shteti, ky është një rreth vicioz i pafundëm, që nuk do të zgjidhet asnjëherë në këtë mënyrë. Propozimi ynë asnjëherë nuk është marrë në konsideratë. Mbase duhet një studim shumë i detajuar edhe nga ekspertë përkatës si të energjisë, ashtu edhe të ujësjellës-kanalizimeve.

Ndriçim Shani – Për agregimin ka pasur një strategji kombëtare që të realizohej me shifra me atë lloj regresioni që ju thatë, që kalohet nga 58, 30, 12, ose dhe në një numër më të vogël. Nga eksperiencia, fatmirësisht, personalisht jam marrë me këtë punë, problemi i agregimit është sa i lehtë në dukje, aq i vështirë për t'u realizuar në praktikë, e sidomos në vendin tonë, në kuptimin që edhe problemet e konfliktualiteteve ose të mbrojtjes së interesave thjesht, që nganjëherë shkojnë përtej asaj të përgjithshmes, bëhet një detyrë mjaft e vështirë. Që të themi të reduktohet pas një viti kaq dhe pas dy vjetësh kaq, është shumë e vështirë të bësh parashikime të tilla. Ajo që ne kemi rekomanduar për këtë është të paktën në vendin tonë të shihen dy-tre raste agregimi të suksesshme, që do të shërbejnë si tregues për shoqëritë e tjera dhe tregues për t'u ndjekur në 70-80% të tyre.

Niko Peleshi– Agregimi po ndodh brenda bashkive.

Ndriçim Shani – Në nivel strategjik, për ekonomi shkalle, është një agregim tjetër që ne propozojmë. Të bëhet një anketim në të gjitha bashkitë e Shqipërisë dhe të shihet ku është predispozita që mund të bëhet, sepse agregimi ka një formulë relativisht të thjeshtë, duhet bërë mbi baza vullnetare dhe me incentiva nga qeveria.

Niko Peleshi - Ose me incentiva.

Ndriçim Shani - Patjetër me incentiva, sepse bashkimet mund të jenë edhe të tilla, një ndërmarrje e shëndetshme me një jo të shëndetshme, sepse ajo, në fakt, që është gropë, do një farë incentivi.

Niko Peleshi- Po, kur janë të dyja të shëndetshme, nuk kanë nevojë.

Ndriçim Shani - Anketimi nxjerr disa raste të mundshme ku ka predispozita për t'u bërë një agregim i suksesshëm dhe pastaj thërritet nga Kryeministri, ky kryetar bashkie që në mënyrë apriori është dakord me këtë punë të bëhen edhe planet përkatëse. Ne si ent rregullator ndihmojmë edhe me tarifa paraprake që mund të jenë në raste agregimi nga studimi që bëjmë dhe të merren edhe rastet përkatëse për incentiva.

Kështu që për shumë arsye e gjej shumë të vështirë të jap shifra që pas kësaj kohe duhet ta reduktojmë kaq e pas kësaj kohe kaq.

Niko Peleshi - Me sa kuptojmë, ka shumë hapësirë për të përmirësuar performancën e ujësjellësve me mirëmenaxhim, pa shkuar në rritje tarifash.

Nëse një ujësjellës ka bërë maksimumin për rritjen e eficiencës dhe rritjen e performancës së menaxhimit, më tej pastaj mund të shikohet dhe mund të ketë nevojë edhe për rritje tarifash, por një ujësjellës që do të kompensojë mungesën e mirëmenaxhimit me rritje tarifash, pra ta mbushë arkën e vet mes tarifave dhe jo nga efienca dhe mirëmenaxhimi, nuk është qasja e duhur. Patjetër qeveria me qasjen e re, me reformën e ujit i ka lidhur në një farë mënyre me performancën. Që pre dy vjetësh qeveria shqiptare inkurajon dhe promovon bashkitë me performancë më të mirë dhe i mbështet ato me investime më shumë se një bashki ose ujësjellës që ka çaluar në performancë. Të paktën kjo është si qasje, por, natyrisht, jemi në proces, jemi në implementim më të mirë të kësaj reforme.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA